

TURKIYE CUMHURİYETİ ZİRAAT BANKASI A.Ş. – Dega në Kosovë

**Pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me
Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar**

Për periudhën që përfundoi me 31 Dhjetor 2016

Përmbajtja

Raporti i auditorit të pavarur	i
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose e humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	3
Pasqyra e rrjedhës së parasë	4
1. Informata të përgjithshme	5
2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël	5
3. Adaptimi i standardeve të reja ose të rishikuara dhe interpretimet	11
4. Interpretimet e reja të kontabilitetit	11
5. Vlerësimet kritike kontabël dhe gjykimet në aplikimin e politikave kontabël	12
6. Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme	14
7. Asetet financiare të gatshme për shitje	15
8. Kreditë dhe paradhëniet për klientët	15
9. Pronat, impiantet dhe pajisjet	16
10. Pasuritë e paprekshme	16
11. Detyrimet ndaj bankave	17
12. Detyrimet ndaj klientëve	17
13. Kapitali	17
14. Të hyrat neto nga interesi	17
15. Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	18
16. Humbja/Fitimi nga këmbimi valutor	18
17. Shpenzimet administrative	18
18. Shpenzimet e tatimit në fitim	19
19. Shpalosje për palët e ndërlidhura	19
20. Artikujt jashtë-bilancor, detyrimet financiare dhe ngjarjet e paparashikuara	20
21. Menaxhimi i rrezikut financiar	21
22. Menaxhimi i rrezikut të kapitalit	28
23. Prezentimi i Instrumenteve Financiare sipas Kategorisë e Matjes	28
24. Zbulueshmëria e vlerës së drejtë	29
25. Ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese	30



Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar Aksionarëve dhe Menaxhmentit të Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S. – dega në Kosovë

Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, gjendjen financiare të Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S. – dega në Kosovë ("Banka") më 31 dhjetor 2016, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Ne kemi audituar:

Pasqyrat financiare të Bankës përfshijnë:

- pasqyra e pozicionit financiar;
- pasqyra e fitimit ose e humbjes dhe të hyrave tjera përmbledhëse;
- pasqyra e ndryshimeve në kapital;
- pasqyra e rrjedhës së parasë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë politika të rëndësishme kontabël.

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" në këtë raport.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën e opinionit tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"), të cilat janë të zbatueshme në auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Kosovës. Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Menaxhmenti i Bankës, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për kontrollin e brendshme, të cilat Menaxhmenti i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Menaxhmenti i Bankës është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur Menaxhmenti synon ta likuidojë Bankën apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen e Bankës janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.



Raporti i audituesit të pavarur (vazhdim)

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një gabim material. Gabimet mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimit material në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një gabim material si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një gabim si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- sigurojmë kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të auditimit, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga Menaxhmenti.
- japim përfundime mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga Menaxhmenti dhe bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri të materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Bankës.
- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që siguron paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Bankës, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontroleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

PricewaterhouseCoopers Kosovo sh.p.k.

PricewaterhouseCoopers Kosovo sh.p.k
Prishtinë, Kosovë
25 prill 2017

TURKIYE CUMHURİYETİ ZIRAAT BANKASI A.S. – Dega në Kosovë

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

<i>Në Euro</i>	Shënime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
ASETET			
Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e parasë	6	1,226,183	5,883,064
Asetet financiare të gatshme për shitje	7	6,618,074	2,507,621
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	8	8,758,704	1,593,695
Pasuritë, pronat dhe pajisjet	9	465,675	593,657
Asetet e paprekshme	10	622,006	749,148
Asetet tjera		4,014	1,478
Pasuria e tatimit të shtyrë në fitim	18	78,966	
Gjithsej Asetet		17,773,622	11,328,663
DETYRIMET			
Detyrime ndaj bankave	11	5,702,475	
Detyrimet ndaj klientëve	12	3,348,594	1,971,715
Detyrimet tjera		40,078	34,422
Gjithsej Detyrimet		9,091,147	2,006,137
KAPITALI			
Kapitali i paguar	13	10,000,000	10,000,000
Humbja e akumuluar		(1,317,525)	(677,474)
Gjithsej Kapitali		8,682,475	9,322,526
Gjithsej Detyrimet dhe Kapitali		17,773,622	11,328,663

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga menaxhmenti ekzekutiv i bankës me datën 14 Prill 2017:

Meriton Sunduri
Menaxher i Degës

Agnesa Vezgishi
Mbikqyrëse e Degës

PASQYRA E FITIMIT OSE E HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA PËRMBLEDHËSE

<i>Në Euro</i>	Shënime	Periudha që përfundoi më 31 Dhjetor 2016	Periudha prej 30 Qershor 2015 deri 31 Dhjetor 2015
Të hyrat nga interesi	14	374,427	35,624
Shpenzimet e interesit	14	(56,881)	(3,885)
Të hyrat neto nga interesi		317,546	31,739
Provizionimi për zhvlerësimin e kredive	8	(73,388)	(16,162)
Të hyrat neto nga interesi pas provizionit për zhvlerësimin e kredive		244,158	15,577
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	15	17,184	2,548
Shpenzimet nga tarifat dhe komisionet	15	(8,207)	(5,148)
Fitimi neto nga kursi i këmbimit	16	1,720	178
Shpenzimet administrative dhe shpenzimet tjera operative	17	(996,200)	(690,629)
Të hyrat tjera operative		22,328	-
Humbja para tatimit		(719,017)	(677,474)
Shpenzimet e tatimit në fitim	18	78,966	-
Humbja gjatë periudhës		(640,051)	(677,474)
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej humbja gjithëpërfshirëse		(640,051)	(677,474)

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

<i>Në Euro</i>	Kapitali i paguar	Humbja e akumuluar	Gjithsej
Më 7 Qershor 2015	-	-	-
Kapitali aksionar	10,000,000	-	10,000,000
Humbja gjatë periudhës	-	(677,474)	(677,474)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Gjithsej humbja gjithëpërfshirëse për periudhën		(677,474)	(677,474)
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	10,000,000	(677,474)	9,322,526
Humbja gjatë periudhës	-	(640,051)	(640,051)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Gjithsej humbja gjithëpërfshirëse për periudhën	-	(640,051)	(640,051)
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	10,000,000	(1,317,525)	8,682,475

PAQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

Në Euro	Shënime	Periudha që përfundoi më 31 Dhjetor 2016	Periudha prej 30 Qershor 2015 deri 31 Dhjetor 2015
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Humbja para tatimit për periudhën		(719,017)	(677,474)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	9,10,17	306,506	157,043
Humbja nga zhvlerësimi i kredive të klientëve	8	73,388	16,162
Të hyrat nga interesi		(374,427)	(35,624)
Shpenzimet e interesit		56,881	3,885
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operative para ndryshimeve në asetet dhe detyrimet operative		(656,669)	(536,008)
<i>Neto (rritja)/zvoglimi në:</i>			
Rezervat e detyrueshme me BQK		4,610,000	(5,000,000)
Kreditë dhe paradhëniet për klientët		(7,240,404)	(1,616,224)
Asete tjera		(2,536)	(1,478)
<i>Neto (rritja)/zvoglimi në:</i>			
Detyrimet ndaj klientëve		1,365,587	1,967,830
Detyrime tjera		5,656	34,422
		(1,899,953)	(5,141,232)
Interesi i arkëtuar		339,091	28,394
Interesi i paguar		(43,113)	-
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative		(1,603,975)	(5,112,838)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerjet e pasurive financiare të gatshme për shitje	7	(6,672,114)	(2,504,250)
Të hyrat nga maturimi i pasurive financiare të gatshme për shitje	7	2,580,591	
Blerjet e pronave dhe pajisjeve	9	(6,779)	(671,383)
Blerjet e aseteve të paprekshme	10	(44,604)	(828,465)
Paraja e shfrytëzuar në aktivitete investuese		(4,142,906)	(4,004,098)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financiare			
Kapitali i ri i regjistruar		-	10,000,000
Të ardhurat nga huat nga bankat e tjera		5,700,000	-
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet financiare		5,700,000	10,000,000
Rritja neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj		(46,881)	883,064
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		883,064	-
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit		836,183	883,064

TURKIYE CUMHURIYETI ZIRAAT BANKASI A.S. – Dega në Kosovë

Shënime të pasqyrave financiare

Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë në Euro ("EUR"), përveq nëse ceket ndryshe)

1. Informata të përgjithshme

Këto pasqyra financiare janë të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për periudhën që përfundoi më 31 Dhjetor 2016 për Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S. – Dega në Kosovë ("Banka").

Banka është degë e huaj e hapur në Republikën e Kosovës nga Banka turke Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S.

Aktiviteti kryesorë. Aktiviteti kryesorë biznesor i Bankës është operacioni komercial dhe me shumicë në kuadër të Republikës së Kosovës. Banka ka operuar nën një licencë të plotë bankare të lëshuar nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK") që nga 2 qershor 2015. Banka filloi operacionin më 7 qershor 2015. Informacionet e vitit paraprak të paraqitura në këto pasqyra financiare mbulojnë periudhën nga 7 qershor 2015 deri më 31 dhjetor 2015.

Banka ka një degë të vetme në Republikën e Kosovës. Banka kishte 11 të punësuar më 31 dhjetor 2016 (2015: 11 të punësuar).

Adresa e regjistruar dhe vendi i biznesit. Adresa e Bankës së regjistruar është Rr. Pashko Vasa nr. 18, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Valuta e shprehur. Këto pasqyra financiare janë të shprehura në Euro ("EUR"), përveq nëse ceket ndryshe.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Bazat e përgaditjes. Banka i përgadit pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") në bazë të konventës së kostos historike, siç modifikohen nga njohja fillestare e instrumenteve financiare, bazuar në vlerën e drejtë dhe nga rivlerësimi i asetëve financiare të gatshme për shitje.

Politikat parësore kontabël të zbatuara në përgaditjen e pasqyrave financiare janë të shpalosura si më poshtë. Këto politika janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura, përveç nëse deklarohet ndryshe.

Instrumentet financiare - Termet kryesore të matjes. Varësisht nga klasifikimi i tyre, instrumentet financiare mbahen me vlerën e drejtë ose me kosto të amortizuar siç përshkruhet më poshtë.

Vlera e drejtë është çmimi që do të pranohej për të shitur një pasuri ose do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt në mes të pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë është çmimi i saj në një treg aktiv. Një treg aktiv është ai në të cilin transaksionet për një pasuri apo detyrim bëhen me shpeshtësi të mjaftueshme dhe vëllim për të siguruar informacion të çmimeve mbi një bazë të vazhdueshme.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare e tregëtuar në një treg aktiv matet kur produkti i çmimit të kuotuar për pasurinë individuale ose detyrimin dhe sasinë e mbajtur nga njësia ekonomike. Ky është rasti edhe në qoftë se volumi normal ditor në treg nuk është i mjaftueshëm për të absorbuar sasinë e mbajtur dhe të urdhëroj që të e shesë pozitën në një transaksion të vetme që mund të ndikojë në çmimin e kuotuar.

Teknikat e vlerësimit sikur modelet zbritëse të rrjedhës se parasë apo modele të bazuara në transaksionet e "arm-length" ose të fundit të shqyrtimit të të dhënave financiare të njësisë ku është investuar, janë përdorur për të matur vlerën e drejtë të instrumenteve të caktuara financiare për të cilat informacioni i çmimit të jashtëm të tregut nuk është në dispozicion.

Matjet e vlerës së drejtë janë analizuar sipas nivelit të hierarkisë së saj sikur edhe më poshtë: (i) niveli i parë janë matjet në çmimet e kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për pasuri ose detyrime identike, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknikat e vlerësimit me të gjitha inputet materiale të dukshme për pasurinë ose detyrimin, në mënyrë të drejtpërdrejtë (që janë çmimet) ose indirekt (që rrjedhin nga çmimet), dhe (iii) matje të nivelit të tretë janë vlerësimet të bazuara jo vetëm në të dhënat e vëzhgueshme të tregut (që është se matja kërkon inpute të rëndësishme të paverifikueshme). Transferet në mes të niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë konsiderohen të kenë ndodhur në fund të periudhës raportuese.

Kostot e transaksioneve janë kosto në rritje të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin e një instrumenti financiar. Një kosto shtesë është ajo që nuk do të kishte ndodhur nëse transaksioni nuk do të kishte ndodhur. Kostot e transaksionit përfshijnë tarifën dhe komisionet e paguara tek agjentët (përfshirë punonjësit që veprojnë si agjentë të shitjes), këshilltarët, agjentët dhe tregtarët, taksat e agjensive rregullatore dhe shkëmbyesit të letrave me vlerë, si dhe taksat e transferimit dhe detyrimet. Kostot e transaksionit nuk përfshijnë primet ose zbritjet e borxheve, apo kostot e financimit të brendshëm administrativ ose kosto e mbajtur.

Kosto e amortizuar është shuma me të cilën instrumenti financiar është njohur në njohjen fillestare minus shlyerjet e principalit, plus interesin e përlllogarit, dhe për aktivet financiare më pak çdo zhvlerësimi për humbjet e shkaktuara nga zhvlerësimi. Interesi i përlllogarit përfshin amortizimin e kostove të transaksionit të shtyra në njohjen fillestare dhe e çdo primi apo zbritje të vlerës në maturim, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet e interesit të përlllogarit, duke përfshirë edhe kuponin e përlllogarit dhe zbritjen apo primin e amortizuar (duke përfshirë tarifën e shtyra në lindje, nëse ka), nuk janë paraqitur veçmas dhe janë të përfshira në vlerat kontabël të artikujve të lidhura në pasqyrën e pozicionit financiar.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Metoda e Normës efektive të interesit është normë e cila i ndanë të ardhurat nga interesi apo shpenzimin e interesit për një periudhë përkatëse, në mënyrë që të arrihet një normë konstante e interesit periodik (normë efektive e interesit) mbi shumën e bartjes.

Norma efektive e interesit është norma që saktësisht zbrzet pagesat apo pranimet e pritura të parasë në të ardhmën (duke përfshirë humbjet nga kreditë në të ardhmën) përmes jetës së pritur të instrumenteve financiare ose periudhës më të shkurtër, nëse është e përshtatshme, deri tek neto vlera bartëse e instrumentit financiar. Norma efektive e interesit zbrzet rrjedhjet e parasë së instrumenteve variabile deri me datën e ardhshme të rivlerësimit të interesit, ku në përjashtim përmenden primet dhe zbritjet të cilat i reflektojnë kreditë e shpërndara në normën lëvizëse të specifikuar tek instrumenti apo tek variablat të cilat nuk janë të përcaktuara me anë të normave të tregut. Premitë e tilla apo zbritjet janë amortizuar gjatë gjithë pritshmërisë së jetës së instrumentit. Kalkulimi i vlerës së tanishme përfshinë të gjitha tarifet e paguara apo të këmbëra ndërmjet palëve të kontraktuara të cilët janë pjesë thelbësore e normës efektive të interesit.

Njohja fillestare e instrumenteve financiare. Instrumentet financiare Banka fillimisht i regjistron në vlerën e tyre të drejtë plus koston e transkasionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshkohet më së miri nga çmimi i transkasionit. Një fitim apo humbje në njohjen fillestare është e regjistruar vetëm në qoftë se egziston një dallim në mes të vlerës së drejtë dhe çmimit të transkasionit i cili mund të dëshkohet nga transaksionet e tregut aktual në të njëjtin instrument ose nga një teknike e vlerësimit, inputet e të cilit përfshijnë vetëm të dhëna nga tregje të mbikqyrura. Të gjitha blerjet dhe shitjet e pasurive financiare përcaktojnë shpërndarje mbrenda afatit të përcaktuar nga rregullorja ose marreveshja e tregut ("mënyrë e rregullt" blerjet dhe shitjet) regjistrohen në datën e tregëtimit, datë e cila është data kur Banka merr përsipër të jap një aset financiar. Të gjitha blerjet e tjera njihen kur entiteti ekonomik bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Banka përdor teknika zbritëse të vlerësimit të rrjedhës së parasë për të përcaktuar vlerën e drejtë të kredive dhe të pasurive financiare në dispozicion për shitje të cilat nuk tregtohen në tregun aktiv. Dallimet mund të lindin midis vlerës fer në njohjen fillestare, e cila konsiderohet të jetë çmimi i transkasionit, dhe shumës së përcaktuar në njohjen fillestare duke përdorur një teknikë vlerësimi me nivel të 3 inuteve. Diferenca të tilla janë fillimisht të njohura tek pasuritë dhe detyrimet tjera dhe më pas janë amortizuar në mënyrë lineare përgjatë afatit të kredive dhe paradhënjeve ndaj klientëve dhe pasurive financiare në dispozicion për shitje. Diferencat menjëherë njihen si fitim ose humbje nëse vlerësimi përdor vetëm nivelin 1 ose nivelin 2 të inuteve.

Mosnjohja e pasurive financiare. Banka nuk i njej pasuritë financiare kur (a) Pasuritë janë riblerë apo të drejtat për rrjedhën e parasë nga pasuritë kanë skaduar (b) Banka ka transferuar të drejtat e rrjedhës së parasë nga pasuritë financiare ose ka hyrë në një marrëveshje kualifikuese përderisa gjithashtu ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por jo mbajtjen e kontrollit. Kontrolli ruhet nëse pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për t'ia shitur pasurinë në tërësi një palë të tretë, pa pasur nevojë të vendos kufizime në shitje.

Paratë dhe ekuivalentët e parasë. Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e saj janë njësi të cilat për një kohë të shkurtër mund të shndërrohen në para të gatshme dhe të cilat i nënshtrohen një rreziku të papërfillshëm të ndryshimit në vlerë. Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e saj përfshijnë Paratë në dorë, rezervat e detyrueshme me Bankën Qendrore të Kosovës ("BQK") dhe të gjitha plasmanet ndërbankare me më pak se 3 muaj të maturimit original. Shumat të cilat kanë të bëjnë me fonde të natyrës restriktive janë të përjashtuara nga paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj. Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto të amortizuar.

Rezervat e detyrueshme për likuiditet Në pajtim me rregullat e BQK-së, Banka duhet të përmbush kushtin e minimumit të likuiditetit mesatar. Kushti i likuiditetit llogaritet në baza javore si 10% të bazës së depozitave, e definuar si mesatarja totale e detyrimeve depozitare ndaj publikut jo-bankar në EUR dhe valuta tjera, përgjatë ditëve të punës të periudhës mirëmbajtëse. Pasuritë me të cilat banka mund të përmbushë kushtin e likuiditetit janë depozitat e EUR në BQK dhe 50% EUR ekuivalent të parasë së gatshme në valuta të gatshme për konvertim. Depozitat me BQK-në nuk mund të jenë më pak se 5% e bazës depozitare të zbatueshme. Pasi pasuritë përkatëse likuide nuk janë të disponueshme për të mbuluar operacionet ditore të bankës, ato janë përjashtuar nga paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj për qëllim të pasqyrës së rrjedhës së parasë. Pasi që Banka ka filluar të operojë në 7 Qershor 2015 përfshirë në rezervë të detyrueshme është Depozitë Ekuivalent i Kapitalit në vlerë prej Euro 5,000,000 të depozituara në BQK.

Bilancet e detyrueshme të mjeteve monetare me BQK mbahen me koston e amortizuar dhe përfaqsojnë depozitat e obligueshme rezerv të cilat nuk mbajnë interes dhe nuk janë në dispozicion për të financuar operacionet e përditëshme të Bankës, dhe për këtë arsye ato nuk konsiderohen si pjesë e parasë apo ekuivalentëve të saj për qëllime të pasqyrimeve të rrjedhjes së parasë

Letra me vlerë tregtare. Letrat me vlerë të tregtueshme janë pasuritë financiare të cilat janë fituar ose për gjenerimin e fitimit nga luhatjet afatshkurtëra në çmim ose në marzhin e tregtarit, ose janë letra me vlerë të përfshira në një portofol, në të cilin egziston një model afatshkurtër i tregtimit. Banka nuka ka letra të tilla ma vlerë deri në datën e raportimit.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Detyrimet nga bankat e tjera. Vlerat e detyrimeve nga bankat e tjera janë të regjistruara kur Banka avancon para për bankat e palës korresponduese pa qëllim të tregëtimit të rezultimit të jo-derivateve të arkëtueshme për shkak të datave fikse apo të përcaktueshme. Vlerat e detyrimeve nga bankat e tjera mbahen me koston e amortizuar.

Huatë dhe paradhëniet për klientë. Kreditë dhe paradhëniet regjistrohen kur Banka avancon para për të blerë ose rrjedh nga jo-derivatet e papërmendura të arkëtueshme nga klienti si pasojë e datave fikse apo të përcaktueshme, andaj nuk ka për synim të i tregtoj të arkëtueshmet. Huatë dhe paradhëniet për klientet mbahen në koston e amortizuar.

Zhvlerësimi i aseteve financiare që mbahen me kosto të amortizuar. Humbjet nga zhvlerësimi njihen si fitim apo humbje për periudhën kur ato ndodhin si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve ("ngjarje të humbjeve") që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të pasurive financiare dhe të cilat kanë një ndikim në sasinë ose kohën e vlerësuar të rrjedhjes së ardhshme monetare të një pasurie financiare ose grupi të pasurisë financiare që mund të vlersohet në mënyrë të besueshme. Nëse Banka përcakton se nuk egziston asnjë synim që zhvlerësimi ka ndodhur për një aset financiar të vlerësuar individualisht, pa marrë parasysh se a është ai i rëndësishëm apo jo, ai përfshinë asetin në një grup të aseteve financiare apo me karakteristikë të ngjashme si të rrezikut të huasë, dhe në mënyrë kolektive e vlerëson atë për zhvlerësim.

Faktorët e parë që Banka konsideron në përcaktimin se a është një pasuri financiare e zhvlerësuar apo jo është statusi i vonuar i tij si dhe aftësia rikuperuese e kolateralit në fjalë, në qoftë se egziston ndonjë. Kriteret e tjera në vijim janë përdorur gjithashtu për të përcaktuar nëse ka evidencë synimi se humbja e shkaktuar nga zhvlerësimi ka ndodhur:

- Ndonjëra prej pagesave është vonuar por jo për arsye të vonësive të shkaktuara nga sistemi që ofron zgjidhje;
- Huamarrësi përjeton vështësi të konsiderueshme financiare sic dëshmohet nga informatat financiare të huamarrësit që Banka i merr;
- Huamarrësi konsideron falimentim apo një riorganizim financiar;
- Ka një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësit si rezultat i ndryshimeve në kushtet ekonomike lokale apo kombëtare që ndikojnë tek huamarrësi; ose
- Vlera e kolateralit është zvogëluar dukshëm si pasojë e përkeqësimit të gjendjes së tregut. Për qëllimet kolektive të evaluimit të zhvlerësimit, asetet financiare janë të grupuara në bazë të karakteristikave të ngjashme të riskut të huasë së tyre. Këto karakteristika kanë të bëjnë me vlerësimin e rrjedhjes së parasë në të ardhmen për grupe të aseteve të tilla, poashtu duke u bërë edhe indikatorë i aftësisë së huamarrësit për t'i paguar të gjitha shumat në kohë të përcaktuar nga ana e kushteve në bazë të së cilës u janë vlerësuar asetet.

Rrjedhja e ardhshme e parasë në grupe financiare të pasurive të cilat në mënyrë kolektive evaluohet për zhvlerësim në baza kontraktuale të rrjedhjeve të saja nga pasuritë dhe përvoja e menaxhmentit në lidhje me shtrirjen e shumave të cilat do të rezultojnë si të vonuara për arsye të ngjarjeve të humbjes dhe të suksesit të rikuperimit nga shumat e vonuara. Përvoja e mëparshme është e rregulluar sipas të dhënave aktuale të vëzhgueshme të cilat reflektojnë në kushtet aktuale që nuk kanë ndikuar në periudhat e mëparshme dhe kanë mënjeluar ndikimin e kushteve të cilat nuk egzistojnë aktualisht.

Në qoftë se kushtet e zhvlerësimit të aseteve financiare mbahen me kosto të amortizuar dhe rinegociohen apo përndryshe modifikohen për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit apo lëshuesit të huasë, atëherë zhvlerësimi matet duke e përdorur efektin original të normës së interesit para modifikimit të kushteve. Asetet e rinegociuara më pas nuk njihen dhe bëhet njohja e aseteve të reja në vlerë të drejtë vetëm në qoftë se rreziku dhe shpërblimi i aseteve ndryshojnë thelbësisht. Kjo ngjarje zakonisht e evidentohet nga një diferencë ndërmjet vlerës aktuale e rrjedhjes origjinale të parasë si dhe rrjedhja e pritur e re e parasë.

Zhvlerësimet e humbjes janë gjithënjë të njohura nga ana e llogarive të lejimeve ku shënohen shumat aktuale të rrjedhjes së pritshme të parasë që këto pasuri i posedojnë (të cilat i përjashtojnë huatë e humbjes që nuk kanë ndodhur ende) këto shumat janë të zbritura nga Norma origjinale efektive e asetit. Llogaritja e vlerës aktuale të rrjedhjes së ardhshme të parasë së vlerësuar nga një aset i kolateralizuar financiar pasqyron rrjedhjen e parasë që mund të rezultojë në zvogëlimin e tarifave të kostove për marrjen apo shitjen e kolateralit, në rast se ajo është e mundur.

Vetëm në periudha pasuese, shumat e zhvlerësimit të humbjes zvogëlohet dhe mund të ndërlidhet objektivisht me ngjarjen që ngjason pas njohjes së zhvlerësimit (një përmirësim i tillë në normat e huasë së huamarrësit) zhvlerësimi i mëparshëm kthehet duke e korigjuar llogarinë e lejimit me anë të fitimit apo humbjes mbrenda periudhës. Pasuritë që nuk mund të mbliidhen, fshihen pasi mirret parasysh zhvlerësimi i provizionimit të humbjes pasi që është ndërmarrë çdo lloj procedure e duhur për rikuperimin e pasurive dhe pasi që shumat e humbjes janë përcaktuar. Rikuperimet e mëpasshme të shumave të shlyera më parë janë kredituar në llogaritë e zhvlerësimit të humbjes në fitim apo humbjen që kanë ndodhur mbrenda periudhës.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Kolaterali i ri-poseduar. Kolaterali i ri-poseduar paraqet pasuritë financiare dhe jo-financiare të cilat janë përfituar nga Banka në zhgjidhjen e vonuar të huave. Pasuritë janë fillimisht të njohura në vlerën e drejtë kur ato mirren dhe përfshihen në premisat dhe pajisjet, apo pasuritë e tjera financiare, investimet në prona apo inventor mbrenda pasurive të tjera duke u bazuar në natyrën e tyre dhe qëllimit të Bankës në kuadër të rikuperimit të pasurive dhe këto janë rrjedhimisht të rivlerësuar dhe të llogaritura në përputhje me politikat kontabël për këto kategori asetesh.

Angazhimet lidhur me kreditin. Banka lëshon angazhime dhe garanci financiare për të siguruar kredi. Garancitë financiare paraqesin garanci të parevokueshme për të bërë pagesat në rast se një klient nuk mund ti përmbushë detyrimet e saj ndaj palëve të treta dhe të mbajë të njejtin risk të kredisë si kreditë. Garancitë dhe angazhimet financiare për të siguruar një kredi janë fillimisht të njohura me vlerën e tyre të drejtë, e cila normalisht është e njohur nga shuma e tarifave të marra.

Kjo shumë amortizohet në menyre lineare mbi jetëgjatësinë e angazhimit, me përjashtim të anagazhimeve për të bërë kredi në qoftë se është e mundur që Banka të hyjë në një marrëveshje të vecantë dhe nuk pret që të shes këto kredi menjëherë pas krijimit të tyre; Tarifat e anagazhimeve të tilla janë të shtyra dhe të përfshira në vlerën kontabël neto të kredisë në njohjen fillestare. Në fund të cdo periudhe raportuese, angazhimet maten me vlerën më të lartë të (i) bilancin e mbetur të paamortizuar të njohjes fillestare dhe (ii) vlerësimin më të mirë të shpenzimit të kërkuar për të bërë angazhimin në fund të cdo periudhe raportimi.

Garantime të performancës. Garantime të performancës janë kontrata që ofrojnë kompensim nëse pala tjetër nuk e përmbush një detyrim kontraktual. Kontrat e tilla transferojnë rrezikun jo-financiar mbi rrezikun e kredisë. Garancionet e performancës fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, e cila normalisht evidentohet nga shuma e tarifave të mara. Kjo shumë amortizohet në mënyrë lineare gjatë jetëgjatësisë së kontratës. Në fund të cdo periudhe raportuese, performanca e kontratave të garancise matet me vlerën më të lartë të (i) bilancit të paamortizuar të shumës në periudhen fillestare dhe (ii) vlerësimin më të mirë të shpenzimit të kërkuar për të vënë kontratën në fund të cdo periudhe raportuese, zbritur në vlerë të drejtë. Kur Banka ka të drejtën kontraktuale për të rikthyer klientit të tij kthimin e shumave të paguara për të bërë marrëveshjen e garancisë, shumat e tilla do të njihen si kredi dhe llogari të arkëtueshme mbi transferimin e kompensimit të humbjeve për përfituesin e garantuesit.

Letrat me vlerë investuese në dispozicion për shitje. Ky klasifikim përfshin letrat me vlerë investuese të cilat Banka synon ti mbajë për një periudhë të pacaktuar dhe të cilat mund të shiten si nevojë për likuiditet ose ndryshim në Norma të interesit, kurset e këmbimit ose cmimet e ekuitetit.

Letrat me vlerë investuese të disponueshme për shitje mbahen me vlerën e drejtë. Të ardhurat nga interesi për letrat me vlerë të gatshme për shitje kalkulohet duke e përdorur metodën e normës efektive të interest dhe njihen në fitim apo humbje për periudhën. Dividentat në instrumentet të gatshme për shitje njihen në fitim apo humbje për periudhën kur e drejta e Bankës për të marrë pagesa rregullohet dhe është e mundur që këto dividenda të mblidhen. Të gjitha elementet e tjera të ndryshimeve në vlerën e drejtë njihen në kapitalin neto derisa investimi c' regjistrohet ose zhvlersohet, ku në këtë kohë fitimi apo humbja kumulative rriklassifikohet nga të ardhura të tjera përmbledhëse në fitim ose humbje për periudhën. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje për periudhën kur ato ndodhin si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve ("ngjarje të humbura") që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të letrave me vlerë investuese të gatshme për shitje. Një rënie e lehtë apo më e theksuar në vlerën e drejtë të një ekuiteti nën koston e tij është një indikator që ai është zhvlersuar. Humbja kumulative nga c'vlersimi – matur si diferenca në mes koston së blerjes dhe vlerës e drejtë, minus ndonjë humbje nga zhvlersimi për atë pasuri të njohur më parë në fitim apo humbje – rriklassifikohet nga të ardhura të tjera në fitim apo humbje për periudhën. Humbjet nga zhvlerësimi i instrumentave të pasurisë nuk janë të kundërta dhe cdo fitimi pasues njihet në kapitalin neto. Në çoftë se mbrenda një periudhe pasuese, vlera e drejtë e investimit të huasë klasifikohet si në dispozicion për rritjen e shitjeve dhe rritja mund të ndërlihet objektivisht me ngjarjen e ndodhur pas njohjes së zhvlerësimit të fitimit apo të humbjes, atëherë zhvlerësimi i humbjes kthehet nga ana e fitimit apo humbjes mbrenda periudhës.

Premiset dhe pajisjet mbahen me kosto minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga dëmtimi, aty ku është e nevojshme. Çdo vit Banka vlerëson nëse ka indikatorë se pasuritë mund të jenë dëmtuara. Nëse ekzistojnë indikatorë të tillë, atëherë vlerësohen shumat e rikthyeshme. Shuma e vlerësuar si të rikthyeshme janë më të larta sesa vlera e drejtë e një pasurie, minus koston për ta shitur dhe vlera e saj në përdorim. Kur vlera kontabël e një pasurie është më e madhe se shuma e vlerësuar e saj e rikthyeshme, atëherë shënohet në shumën e rikthyeshme dhe diferenca i ngarkohet fitimit dhe humbjes.

Fitimet dhe humbjet e pronës, objekteve dhe pajisjeve përcaktohen sipas referimit në vlerën e tyre kontabël dhe merren parasysh në përcaktimin e rezultateve operative për atë periudhë. Riparimet dhe mirëmbajtjet i ngarkohen fitimit dhe humbjet aty ku ka pasur shpenzime. Zhvlerësimi zbatohet duke përdorur metodën e direkte, përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të dobishme të çdo gjëje të pronës dhe pajisjeve. Zhvlerësimet e mëtutjeshme zbatohen në muajin pasues të blerjes ndërsa për largimin e tyre deri në muajin e largimit nga librat kontabel. Zhvlerësimi nuk fillon derisa pasuritë të jenë të gatshme për shfrytëzim.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Normat vjetore të zhvlerësimit të përdorura për secilën kategori të pronës, ndërtesave dhe pajisjeve janë:

Kategoria e pasurive	Periodha e zhvlerësimit
Përmirësimi i objekteve të marra me qira	5 vite apo afati i qirasë, cilido që është më i shkurtër
Mobiljet dhe pajisjet tjera	5 vite
Kompjuterët dhe pajisjet përcjallëse	5 vite
Automjetet motorike	5 vite

Pasuritë e paprekshme Pasuritë fizike të fituara nga Banka mbahen me kosto duke e zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga dëmtimi aty ku është e nevojshme. Amortizimi zbatohet në bazë të metodës lineare me normë vjetore prej 20%.

Shpenzimet e mëpasshme në pasuritë e kapitalizuara jo-fizike kapitalizohen vetëm kur rrit përfitimet e ardhshme fizike të mishëruara në pasuritë fizike përkatëse. Të gjitha harxhimet tjera janë shpenzime të shkaktuara. Amortizimi nuk fillon derisa pasuritë të jenë të gatshme për shfrytëzim.

Zhvlerësimi i pasurive jo-financiare Një humbje nga zhvlerësimi njihet sa herë që vlera kontabël e një pasurie e tejkalon shumën e tij të rikthyeshme. Shuma e rikthyeshme e një pasurie është më e lartë se vlera e drejtë e saj minus kostoja për shitje dhe vlera e saj në përdorim. Vlera në përdorim e një pasurie është vlera aktuale e rrjedhave të vlerësuara të ardhshme të parasë të pritura nga shfrytëzimi i vazhdueshëm dhe nga hedhja e tij.

Detyrimet ndaj bankave Detyrime ndaj bankave janë të regjistruara kur paratë ose asetet tjera janë dhënë si avanc në bankë nga bankat e palëve tjera. Detyrimet jo-derivative realizohen me kosto të amortizuara. Nëse Banka e blen borxhin e saj, detyrimi fshihet prej bilancit të gjendjes dhe diferenca në mes të vlerës së detyrimit dhe pagesës së kryer përfshihet tek humbja apo fitimi nga mbyllja e parakohshme e borxhit.

Detyrimet për klientët janë detyrime jo-derivative ndaj individëve, shtetit apo bizneseve dhe mbahen me kosto të amortizuara.

Huamarrje fillimisht regjistrohen me vlerë të drejtë, neto të kostove të transaksionit. Huamarrjet më pas mbahen me kosto të amortizuara. Çdo interes apo tarifë që ka të bëjë me fondet e marura si hua është shpenzim sipas normës efektive të interesit dhe e paraqitur në fitim dhe humbje për periudhën. Kostot e huamarrjes që lidhen në mënyrë direkte me blerjen, konstruktimin apo prodhimin e një aseti që nuk është i gatshëm për shitje, njihen si pjesë e kostos së asetit. Të gjitha kostot tjera të huamarrjes njihen si shpenzime të periudhës së cilës i takojnë.

Tatimi në të hyra. Tatimet në të hyra janë të llogaritura në pasqyrat financiare bazuar në legjislacionin e miratuar ose konsiderisht i miratuar në fund të periudhës së raportimit. Ngarkimi me tatim në të ardhura në fitim dhe humbje për periudhën përbëhet nga tatimi aktual dhe ndryshimet në tatimin e shtyrë, vetëm nëse është e njohur në të hyrat tjera të përgjithshme ose direkt në ekuitet sepse lidhet me transaksionet të cilat janë gjithashtu të njohura në periudha të njëjta ose të ndryshme në të hyrat e tjera të përgjithshme ose direkt në ekuitet.

Tatimi aktual është shuma e pritshme që duhet paguar ose mbuluar nga autoritetet e tatimeve në lidhje me fitimet e tatushme ose humbjet për periudhën e tanishme dhe të mëparëshme. Fitimet ose humbjet në tatim bazohen në vlerësimin nëse pasqyrat financiare janë paraprakisht të autorizuara për të përmbyshur kthimet relevante të tatimeve. Tatimet tjera, përveç tatimit në të ardhura, regjistrohen në kuadër të shpenzimeve operative.

Tatimi i shtyrë në të ardhura llogaritet duke përdorur metodën e obligimit të bilancit të gjendjes për diferencat e përkohshme që dalin nga baza e tatimeve të pasurive dhe detyrimeve, dhe shumat e tyre bartëse për qëllime të raportimit financiar.

Duke u bazuar në përjashtimet fillestare të njohura, tatimet e shtyra nuk janë të regjistruara për diferencat e përkohshme në regjistrimet fillestare të një aseti ose detyrimi në një transaksion tjetër, i ndryshëm nga një kombinim biznesi nëse transaksioni i cili në fillim është regjistruar nuk ka ndikim në kontabilitet dhe në fitimin e tatushëm. Balancat e tatimit të shtyrë maten me normë tatimi të miratuar ose konsiderisht të miratuara në fund të periudhës së raportuar, të cilat priten të aplikohen në periudhën në të cilën diferencat e përkohshme do të rikthehen ose humbja në tatim do të shfrytëzohen.

Pasuritë e tatimit të shtyrë regjistrohen deri në atë masë që ka të ngjarë se fitimi i ardhshëm i tatueshëm do të jetë i disponueshëm, ndaj së cilave diferencat e përkohshme mund të shfrytëzohen.

Provizionet për detyrime dhe ngarkesat. Provizionet për detyrimet dhe ngarkesat janë detyrime jo-financiare të një periudhe ose shumë të pasigurt. Ato njihen kur Banka ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv si rezultat i ngjarjeve të kaluara, dhe ka shumë mundësi që të ekzistojë një dalje burimesh ekonomike që kërkohet për të shlyer detyrimin; dhe një parashikim i besueshëm i shumës së një detyrimi mund të bëhet.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Llogaritë e tjera të pagueshme. Llogarite e pagueshme njihen kur pala tjetër ka performuar obligimet e tyre në lidhje me kontratën dhe mbahen me koston e amortizuar.

Kapitali aksionar. Forma ligjore e bankës është degë dhe si të tilla aksionet e saj në kapitalin aksionar janë të klasifikuar si kapital. Kostot rritëse ngarkohen drejtpërdrejtë me cështjen e aksioneve të reja (ose opsioneve) të cilat shfaqen në kapital si zbritje, neto i tatimit nga të ardhurat. Cdo tejkalim i vlerës së drejtë të shumës së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara është e regjistruar si prim i aksionit në kapital (Shënimi 1.3).

Njohja e shpenzimeve dhe të ardhurave. Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit janë të njohura për të gjitha instrumentet e borgjit në baza akruale duke përdorur metodën efektive të interesit. Kjo metodë shtynë, si pjesë e të ardhurave nga interesi dhe shpenzimeve, të gjitha komisionet e paguara ose të pranuar në mes të palëve të kontraktuara të cilat janë një pjesë e rëndësishme e normës efektive të interesit, kostove të transaksionit dhe të gjitha primet ose zbritjeve të tjera.

Tarifat pjesë të rëndësishme për normën efektive të interesit përfshijnë tarifën e pranuar ose të paguar nga entiteti në lidhje me krijimin ose blerjen e një asemi financiar ose lëshimi i një detyrimi financiar. Tarifën e angazhuara të pranuar nga Banka për origjinën e kredive në normat e interesit të tregut janë të integrale në normën efektive të interesit në qoftë se është e mundur që Banka do të hyjë në një marrëveshje të vecantë të kreditimit dhe nuk pret për të shitur kredinë e rezultuar menjëherë mbas origjinës. Banka nuk cakton angazhimet e kredive si detyrime financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Kur kreditë dhe instrumentet tjera të borgjit bëhen të dyshimta në kolektim, ato janë shkruara deri në vlerën e tanishme të fluksit të pritshëm të parasë dhe të hyrave nga interesi regjistrohen më pas për vlerën aktuale të diskontuar bazuar në normën efektive të interesit të asetit i cili është përdorur për të matur humbjet nga dëmtimet.

Të gjitha tarifën e tjera, komisionet, shpenzimet dhe të ardhurat e tjera janë të llogaritura në bazat akruale duke i'u referuar përfundimit të një transaksioni të vecantë të vlerësuar mbi bazën e shërbimit aktual të parashikuar si përqindje e totalit të shërbimeve të ofruara.

Monedhat e huaja. Monedha funksionale e bankës është Euro sic është edhe monedha primare e ekonomisë së vendit në të cilin Banka operon dhe reflekton thelbin ekonomik të ngjarjeve themelore.

Asetet dhe detyrimet monetare janë të përkthyer në monedhën funksionale të cdo entiteti me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës Qëndrore të Kosovës ("BQK") në fund të periudhës përkatëse raportuese. Humbjet dhe fitimet të këmbimeve të huaja që rezultojnë nga shlyerja e transaksioneve dhe nga përkthimi i detyrimeve dhe aseteve monetare në secilën monedhë funksionale të bankës në normën zyrtare të këmbimit të BQK në fund të vitit, janë të njohura në fitim ose humbje për vitin (sikur përkthimi i këmbimeve të huaja fiton më pak humbje). Përkthimi i normave të fund vitit nuk aplikohet për zërat jo-monetarë të cilat maten me kosto historike.

Zërat jo - monetarë të matura në vlerë të drejtë në një monedhë të huaj, duke përfshirë edhe investimet në capital, janë të përkthyer duke përdorur normën e këmbimit në ditën kur vlera e drejtë është përcaktuar.

Efektet e ndryshimeve të normave të këmbimit në zërat jo-monetarë të matura në vlerën e drejtë në një monedhë të huaj janë të regjistruar si pjesë e vlerës së drejtë të humbur ose fituar.

Përfitimet e të punësuarve. Banka paguan kontribute për planin pensional të administruar nga Trusti Pensional i Kosovës (TKPK) në baza të obligueshme. Banka nuk ka detyrime të tjera për pagesa pasi që kontributet të paguhen. Kontributet regjistrohen si shpenzime për përfitim të punësuarve atëherë kur ato duhet të paguhen.

Qiratë operative. Kur Banka është qiramarrës në një qira e cila nuk transferon të gjithë riskun dhe shpërblimet rastësisht për pronësi nga qiradhënësi tek Banka, pjesa totale e pagesës vendoset si fitim ose humbje për periudhën (shpenzime të qirasë) në metodë lineare përgjatë periudhës së qirasë.

3. Adaptimi i standardeve të reja ose të rishikuara dhe interpretimet

Standardet e reja në vijim hyjnë në fuqi për Grupin që 1 January 2016, por nuk kanë ndonjë ndikim material për Grupin:

- SNRF 14, Llogaritë e shtyra (publikuar në Janar të vitit 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2016).
- Kontabiliteti për fitimin e interesave në operacione të përbashkëta - Ndryshimet në SNRF 11 (publikuar më 6 Maj 2014 dhe në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2016).
- Sqarimi i metodave të pranueshme të zhvlerësimit dhe amortizimit - ndryshime në SNK 16 dhe SNK 38 (të publikuara më 12 Maj 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).
- Bujqësia: Bimë rritësit - Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 41 (të publikuara më 30 Qershor 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2016).
- Metoda të kapitalit në pasqyrat financiare individuale - Ndryshimet në SNK 27 (publikuar më 12 Gusht 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2016).
- Përmirësimet vjetore në SNRF-të të vitit 2014 (publikuar më 25 Shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2016).
- Ndryshimet në dhënien e shpjegimeve financiare sipas SNK 1 (publikuar në Dhjetor 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore në ose pas 1 Janar 2016).
- Subjektet investitore: Aplikimi i amendamentit të përjashtimit të konsolidimit sipas SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 (publikuar në Dhjetor 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore në ose pas 1 Janar 2016).

Adaptimi i këtyre ndryshimeve të standardeve ekzistuese nuk ka pasuar me ndryshime materiale në pasqyrat financiare kompanisë.

4. Interpretimet e reja të kontabilitetit

Disa interpretime dhe standarde të reja janë lëshuar dhe të cilat janë mandatore për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janari 2016 ose më vonë dhe të cilat Banka më parë nuk i ka pranuar.

SNRF 9 "Instrumentet financiare: Klasifikimi dhe Matja" (publikuar në Korrik 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore në ose pas 1 Janari-t 2018). Karakteristikat e standardeve të reja janë

- Asetet financiare kërkohen që të klasifikohen në tri kategori të matjeve: ato të cilat maten me koston e amortizuar, ato të cilat do të maten me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera të përgjithshme (FVOCI) dhe atyre që do të maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVPL).
- Klasifikimi i instrumenteve të borgjit është i marrë nga modeli i entiteteve të biznesit për menagjimin e aseteve financiare dhe nëse flukset kontraktuale të parasë përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit (SPPI). Nëse një instrument borgji është mbajtur për tu mbledhur, ajo mund të mbahet në koston e amortizuar nëse ajo gjithashtu plotëson kërkesat e SPPI. Instrumentet e borgjit të cilat plotësojnë kërkesat e SPPI të cilat janë të mbajtura në portfolio në të cilën një entitet i mban për të mbledhur asetet e rrjedhës së keshit dhe shet asetet mund të klasifikohen si FVOCI. Asetet financiare të cilat nuk përmbajnë rrjedhën e parasë të cilat janë SPPI duhet të maten me FVPL (p.sh: derivatet). Derivatet e përfshira nuk janë të ndara nga asetet financiare, por do të përfshihen në vlerësimin e gjendjes së SPPI.
- Investimet në instrumentet e kapitalit janë gjithmonë të matura në vlerën e drejtë. Megjithatë, menagjimenti mund të bëjë një zgjedhje të pakthyeshme për të paraqitur ndryshimet në vlerën e drejtë në të ardhurat e tjera përmbledhëse, me kusht që instrumenti nuk mbahet për tregtim. Nëse instrumenti i kapitalit është i mbajtur për tregtim, ndryshimet në vlerën e drejtë janë të paraqitura në fitim ose humbje.
- Shumica e kërkesave në SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare janë të bartur të pandryshuar në SNRF 9. Ndryshimi kryesor është që një entitet do t'i kërkohet që të tregojë efektet e ndryshimeve në riskun e tyre të kreditit të detyrimeve financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në të ardhurat tjera përmbledhëse.
- SNRF 9 paraqet një model të ri për njohjen e humbjeve nga dëmtimi-modeli i humbjeve të pritshme të kreditit (ECL). Ekziston një qasje e "tre fazave" e cila është bazuar në ndryshimin e kualitetit të kredisë së asteve financiare që nga njohja fillestare. Në praktikë, rregullat e reja nënkuptojnë se entiteti do të duhet t'i regjistrojë një humbje të menjëherëshme të barabartë me 12-mujtë e ECL në njohjen fillestare të aseteve financiare të cilat nuk janë të dëmtuara (ose jetëgjatësia e ECL për llogaritë e arkëtueshme). Në vendin ku ka pasur një rritje të konsiderueshme në riskun e kreditit, dëmtimet maten duke përdorur jetëgjatësinë ECL në vend të 12-mujore të ECL. Modeli përfshinë thjeshtësimet operative për qiranë dhe llogaritë e arkëtueshme.

4. Interpretimet e reja të kontabilitetit (vazhdim)

- Kërkesat e reja të kontabilitetit mbrojtës janë ndryshuar në mënyrë që të lidhen ngushtë me menagjimin e riskut. Standardi i ofron entiteteve me një zgjedhje në politikat kontable në mes të zbatimit të kërkesave mbrojtëse të kontabilitetit të SNRF 9 dhe vazhdimësia për të aplikuar SNK 39 në të gjitha mbrojtjet sepse standardi aktualisht nuk adreson kontabilitetin e mbrojtjes makro.

Standardi pritet të ketë një ndikim të rëndësishëm në provizionet e dëmtuara të kredisë. Zyra qendrore e bankës është aktualisht duke vlerësuar ndikimin e standardit të ri në pasqyrat financiare.

SNRF 15, të ardhurat nga kontratat me klientët (publikuar më 28 Maj 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janari-t 2018). Standardi i ri paraqet parimin bazë se të ardhurat duhet të njihen kur të mirat ose shërbimet janë të transferuar tek klienti, me cmimin e transaksionit. Cdo pako e mallit dhe shërbimit që janë të dalluara duhet të njihen vecas dhe cdo zbritje ose rabat në cmimin e kontratës duhet të përgjithësi të alokohen në elemente të vecanta. Në rastin kur ndryshon për çfardo arsye, shuma minimale duhet të njihet nëse ato nuk janë në një risk të rëndësishëm të rikthimit. Shpenzimet që ndodhin për të siguruar kontratat me klientët duhet të kapitalizohen dhe amortizohen përgjatë periudhës kur përfitimet nga kontratat janë marrë.

SNRF 16 "Qiratë" (publikuar në Janar të vitit 2016, në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2019)

Standardi i ripërcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin e qirasë. Të gjitha qiratë rezultojnë tek qiramarrësi i cili mban të drejtën dhe financimin për të përdorur një aset në fillim të qirasë nëse pagesat e qirasë bëhen me kalimin e kohës. Në këtë mënyrë, SNRF 16 elimanon klasifikimin e qirasë ose si qira operative ose sikur qira financiare sic kërkohet në SNK 17 dhe në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm kontabël të qiramarrësit. Qiramarrësit do t'ju kërkohen që të njohin: a) asetet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me afat prej më shumë se 12 muaj, vetëm nëse asetit është në vlerën më të ulët; dhe b) zhvlerësimi i aseteve me qira vecmas nga interesi në detyrimet e qirasë në pasqyrën e të ardhurave. SNRF 16 në mënyrë substanciale mbart kërkesat kontable të qiramarrësit në SNK 17. Në këtë mënyrë, një qiramarrës vazhdon të klasifikojë qiranë e tij si një qira operative ose financiare dhe vecmas të japin llogari për këto dy tipe të qirasë.

Iniciativa për dhënien e shpjegimeve financiare, ndryshimet në SNK 7 (publikuar më 29 Janar 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2017).

Ndryshimet në SNK 7 do të kërkojë dhënien e informacioneve shpjeguese në levizjen e detyrimeve të cilat ndodhin gjatë aktiviteteve financiare. Grupi do të paraqesë këtë zbulim në pasqyrat financiare të 2017.

Prononcimet e reja në vijim nuk priten të kenë një ndikim paterial në Grup kur të miratohen:

- Shitja apo kontributi i pasurive mes një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (të publikuar më 11 Shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës të përcaktuar nga IASB).
- Ndryshimet në SNK 12 në lidhje me njohjen e pasurive tatimore të shtyra për humbjet e porealizuara (publikuar në 19 Janar të vitit 2016, në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2017)
- Ndryshimet në SNRF 15, të ardhurat nga kontratat me klientët (publikuar me 12 Prill 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janari 2018).
- Ndryshimet në SNRF 2, Pagesa përmes aksioneve (publikuar me 20 Qershor 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janari 2018).
- Ndryshimet në SNRF 4, Kontratat e sigurimit (publikuar më 12 Shtator 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janari 2018).

Përveç nëse më lartë përshkruhet ndryshe, standardet dhe interpretimet e reja nuk priten të kenë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të bankës.

5. Vlerësimet kritike kontabël dhe gjykimet në aplikimin e politikave kontabël

Banka bën vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë shumë në njohur në pasqyrat financiare dhe shumat e mbajtura të aseteve dhe detyrimeve Brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet janë në vazhdimësi të rishikuara dhe bazohen në eksperiencat e menagjimentit dhe faktorëve të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave. Menagjimenti gjithashtu bën gjykime të caktuara, përveç atyre që përfshijnë vlerësimet, në procesin e aplikimit të politikave kontabël. Gjykimet të cilat kanë efektet më të rëndësishme në vlerat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet të cilat mund të shkaktojnë një rregullim të rëndësishëm në vlerën kontabël të aseteve dhe detyrimeve mbrenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

5. Vlerësimet kritike kontabël dhe gjykimet në aplikimin e politikave kontabël

Zhvlërimi i investimeve kapitale të gatshme për shitje. Banka përcakton së instrumentet e kapitalit në dispozicion për shitje janë zhvlërsuar kur ka pasur një rënje e rëndësishme dhe të zgjatur në vlerën e drejtë nën koston e saj. Ky përcaktim i asaj se çfarë është e rëndësishme dhe e zgjatur kërkon për tu gjykuar. Në marrjen e këtij gjykimi, Banka vlerëson në mesin e faktorëve të tjerë, paqëndrueshmërinë e cmimit të aksionit. Përveç kësaj, zhvlërimi mund të jetë e përshtatshme kur ka prova të ndryshmeve në teknologji ose në përkeqësimin e shëndetit financiar të investuarit, industria dhe performanca e sektorit ose rrjedha e parasë financiare ose operative.

Sikur të gjitha rëniet në vlerën e drejtë nën kosto konsiderohen të rëndësishme ose të zgjatura, Banka do të pësojë një humbje nga zhvlërimi prej EUR 69 mijë, duke qenë një riklasifikim nga të ardhurat e tjera përmbledhëse në fitim ose humbje për vitin.

Humbjet nga zhvlërimi i huave dhe paradhënive për klientët. Banka rishikon rregullisht portfoliet e saja të kredisë për të vlerësuar zhvlërimin. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlërimi duhet të regjistrohet në fitim ose humbje për periudhën, atëherë Banka e jep vlerësimin e tij duke u bazuar se a ka ndonjë informatë të vëzhgueshme që parashih se egziston ndonjë zbritje të matshme në rrjedhjen e ardhme të vlerësimit të parasë nga portfoliet apo huatë para se të zbatohet zvogëlimi që mund të identifikohet kur një individ ka hua në atë portfolio. Kjo evidenc mund të përmbaj informata të vëzhgueshme që kanë rënë në kundërshtim me ndryshimet në statusin e pagesës së huamarrësve në bankë, apo ndonjë kusht kombëtar apo ndërkombëtar që mund të ndërliken me parazgjidhjet e pasurive në atë grup. Menaxhmenti përdor vlerësime në bazë të përvojës në humbjet historike të pasurive me karakteristikat e rrezikshmërisë së huasë si dhe sipas evidences së zhvlërimin që është i ngjashëm me ato në portofolio kur përcaktohen rrjedhjet e ardhshme të parasë. Metodologjia e supozimit që përdoret për vlerësimin e kohës së rrjedhjes së ardhshme të parasë parashihet të e zvogëloj diferencën ndërmjet humbjes dhe përvojës së vërtetë të humbjes.

Një 10 % rritje ose ulje në humbjen aktuale të përvojës krahasuar me vlerësimet e përdorura të humbjes do të rezultojë në një rritje ose ulje të humbjeve të impairment të kredisë për EUR 9 mijë (2015: EUR 3 mijë), respektivisht.

TURKIYE CUMHURIYETI ZIRAAT BANKASI A.S. – Dega në Kosovë**Shënime të pasqyrave financiare**

Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016

*(Të gjitha shumat janë në Euro ("EUR"), përveq nëse ceket ndryshe)***6. Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme**

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Paraja në dorë	83,336	14,116
Llogaritë rrjedhëse në bankat	37,598	46,431
<i>Paraje e mbajtur në BQK</i>		
Llogaria rrjedhëse	715,249	822,517
Rezerva e obligueshme	390,000	5,000,000
Gjithsej paraja, ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme	1,226,183	5,883,064

Paraja dhe ekuivalentët e saj ne pasyrën e rrjedhjes së parasë përbëhet nga:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Paraja dhe ekuivalentët e saj dhe rezervat e detyrueshme	1,226,183	5,883,064
Llogaria e rezervave të detyrueshme	(390,000)	(5,000,000)
Paraja dhe ekuivalentët e saj	836,183	883,064

Llogaria rezervat e detyrueshme përfaqëson Depozitat Kapitale ekuivalente ("CED"), të cilat sipas rregullores së BQK-së për depozitat kapitale ekuivalente për degët e bankave të huaja është e nevojshme me këtë Rregullore të vendosin në BQK në vend të kapitalit të lëshuar të aksioneve, një Depozitë Kapitale Ekuivalente në shumën prej EUR 7,000,000 milion euro për ngritjen e degës së saj dhe kjo kërkesë nuk mund të përjashtohet për ndonjë arsye. Depozitat Kapitale ekuivalente në bazë të kësaj rregulloreje mund të investohen në: 1) depozitat në BQK 2) Letra me vlerë të lëshuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe 3) Investimet në institucion tjetër pas miratimit të BQK-së. Me 31 Dhjetor 2016 Depozitat Kapitale ekuivalente të bankës përbëhen nga bilanci në BQK Euro 390,000 dhe Euro 6,610,000 investime në letra me vlerë të lëshuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (Shënim 7).

TURKIYE CUMHURİYETİ ZIRAAT BANKASI A.S. – Dega në Kosovë**Shënime të pasqyrave financiare**

Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016

*(Të gjitha shumat janë në Euro ("EUR"), përveq nëse ceket ndryshe)***7. Asetet financiare të gatshme për shitje**

Asetet financiare të gatshme për shitje, Euro 6,618,074 me 31 Dhjetor 2016 paraqesin bonot e thesarit dhe obligacionet të lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Bonot e thesarit të qeverisë dhe obligacionet e rendimentit duke filluar nga 0.2 % to 3.19%. Investimet në bonot e thesarit janë gjithashtu të përdorura si depozita ekuivalente të kapitalit të kërkuara për një degë të një banke të huaj. (Shënim 6.)

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Bonot e thesarit	3,705,227	1,181,724
Obligacionet e qeverisë	2,912,847	1,325,897
Gjithsej pasuritë e gatshme për shitje	6,618,074	2,507,621

Lëvizjet në pasuritë financiare të gatshme për shitje janë si në vijim:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Balanca fillestare	2,507,621	-
Blerjet gjatë periudhës	6,672,114	2,504,250
Interesi i akumuluar	73,938	3,371
Interesi i fituar	(55,008)	-
Letrat me vlerë të maturuara	(2,580,591)	-
Balanci më 31.12.2016	6,618,074	2,507,621

8. Kreditë dhe paradhëniet për klientët

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Kreditë e klientëve	7,255,555	1,125,207
Mbitërheqjet	1,356,481	371,450
Kreditë individuale	212,716	110,280
Kreditë e stafit	23,502	2,920
	8,848,254	1,609,857
Provizionet për humbjet nga kreditë	(89,550)	(16,162)
Gjithsej kreditë e klientëve (neto)	8,758,704	1,593,695

Huatë dhe paradhënie për klientë përfshijnë të ardhurat nga interesi i akumuluar në vlerë prej Euro 20,265 (2015: 3,859). Me 31 Dhjetor 2016 Banka kishte 87 huamarrës. 77% i portofolit të kredisë është i koncentruar në 10 huamarrësit më të mëdhenj prej të cilëve huamarrësi më i madh përbën 56% të portofolit të kredisë, i cili operon në sektorin e shitjes komerciale me shumicë. Objektet e mbitërheqjes përfaqsojnë objekte me afat të shkurtër.

Lëvizjet në shpenzimet e zhvlerësimit për humbjet nga kreditë janë si në vijim:

	2016	2015
Me 1 Janar/7 Qershor	16,162	-
Shpenzimi gjatë periudhës	73,388	16,162
Huatë e shlyera	-	-
Me 31 Dhjetor	89,550	16,162

Përqëndrimet në rrezikun e sektorit ekonomik mbrenda portofolit të huave të klientëve janë si në vijim:

Sektori industrial	31 Dhjetor 2016		31 Dhjetor 2015	
Shitja komerciale me shumicë	6,999,199	80%	1,010,221	63%
Prodhimet	275,620	3%	230,444	14%
Shërbimet	860,863	10%	43,445	4%
Shëndeti njerëzor dhe aktivitetet e punës sociale	384,734	4%	198,024	12%
Amvisëria	238,288	3%	115,561	7%
	8,758,704	100%	1,593,695	100%

TURKIYE CUMHURİYETİ ZIRAAT BANKASI A.S. – Dega në Kosovë

Shënime të pasqyrave financiare

Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë në Euro ("EUR"), përveq nëse ceket ndryshe)

9. Pronat, impjantet dhe pajisjet

	Riparimet e objekteve të marra me qira	Mobiljet, orenditë dhe pajisjet	Kompjuterët dhe pajisjet përcjellëse	Automjetet	Gjithsej
Kostoja:					
Shtesat gjatë periudhës	259,516	7,480	371,887	32,500	671,383
31 Dhjetor 2015	259,516	7,480	371,887	32,500	671,383
Zhvlerësimi i akumuluar:					
Shpenzimi për periudhën	(29,718)	(873)	(43,343)	(3,792)	(77,726)
31 Dhjetor 2015	(29,718)	(873)	(43,343)	(3,792)	(77,726)
Neto vlera kontabël					
31 Dhjetor 2015	229,798	6,607	328,544	28,708	593,657
Kostoja:					
Balanca me 1 Janar 2016	259,516	7,480	371,887	32,500	671,383
Shtesat gjatë periudhës		3,600	3,179		6,779
31 Dhjetor 2016	259,516	11,080	375,066	32,500	678,162
Zhvlerësimi i akumuluar:					
Balanca me 1 Janar 2016	(29,718)	(873)	(43,343)	(3,792)	(77,726)
Shpenzimi për periudhën	(51,903)	(1,556)	(74,801)	(6,500)	(134,760)
31 Dhjetor 2016	(81,621)	(2,429)	(118,144)	(10,292)	(212,486)
Neto vlera kontabël					
31 Dhjetor 2016	177,895	8,651	256,922	22,208	465,675

10. Pasuritë e paprekshme

	Softueri	Liqenca	Gjithsej
Kostoja:			
Shtesat gjatë periudhës	786,398	42,067	828,465
31 Dhjetor 2015	786,398	42,067	828,465
Shpenzimi për periudhën	75,576	3,741	79,317
31 Dhjetor 2015	75,576	3,741	79,317
Neto vlera kontabël:			
31 Dhjetor 2015	710,822	38,326	749,148
Kostoja:			
Shtesat gjatë periudhës	786,398	42,067	828,465
	44,604	-	44,604
31 Dhjetor 2016	831,002	42,067	873,069
Balanca me Janar 2016	75,576	3,741	79,317
Shpenzimi për periudhën	163,333	8,413	171,746
31 Dhjetor 2016	238,909	12,154	251,063
Neto vlera kontabël:			
31 Dhjetor 2016	592,093	29,913	622,006

Të gjitha pasuritë e paprekshme janë pasuri të fituara dhe të amortizuara përgjatë jetëgjatësisë së tyre të dobishme.

TURKIYE CUMHURIYETI ZIRAAT BANKASI A.S. – Dega në Kosovë**Shënime të pasqyrave financiare**

Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016

*(Të gjitha shumat janë në Euro ("EUR"), përveq nëse ceket ndryshe)***11. Detyrimet ndaj bankave**

Detyrimet ndaj bankave janë me maturitet deri në një muaj dhe me normë interesi vjetor 1%.

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Ziraat Bankasi – Dega në Sofie	5,702,475	-
Gjithsej detyrimet për Bankën	5,702,475	-

12. Detyrimet ndaj klientëve

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Depozitat pa afat		
Individët	328,641	137,810
Personat juridik	706,741	493,021
	1,035,382	630,831
Depozitat me afat		
Individët	1,153,525	237,991
Personat juridik	1,159,687	1,102,893
	2,313,212	1,340,884
Gjithsej detyrimet ndaj klientëve	3,348,594	1,971,715

Me 31 Dhjetor 2016 Banka ka 480 klientë. 81% të depozitorëve janë të koncentruar në 10 depozitorët më të mëdhenjë dhe 68% në 5 depozitorët më të mëdhenj. Në depozita është i përfshirë edhe interesi i akumuluar prej EUR 15,177 (2015: 13,246).

13. Kapitali

Banka është degë e jashtme e Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A. Sipas rregullores së BQK-së për depozitat kapitale ekuivalente për degët e huaja, banka kërkohet nga kjo rregullore të vendos që së bashku me BQK-në rreth kapitalit, një CED në vlerë prej Euro 7,000,000 për ngritjen e degës së saj.

T.C. Ziraat Bank A.S. Turkey ka kontribuar me EUR 10,000 mijë në ekuitetin e degës sipas kërkesave të rregullatorit.

14. Të hyrat neto nga interesi

	Periudha që përfundoi më 31 Dhjetor 2016	Periudha prej 30 Qershor 2015 deri 31 Dhjetor 2015
Interest income		
Të hyrat nga kreditë dhe parapagimet e klientëve	245,463	26,339
Të hyrat nga pasuritë financiare të disponueshme për shitje	73,938	3,371
Të hyrat nga overdraft	55,026	5,914
Gjithsej të hyrat nga interesi	374,427	35,624
Shpenzimet për interes		
Interesi në depozitat me afat	(32,778)	(3,885)
Shpenzimet e interesit nga huamarrjet	(24,103)	-
Gjithsej shpenzimet e interesit	(56,881)	(3,885)
Të hyrat neto nga interesi	(317,546)	(31,739)

TURKIYE CUMHURİYETİ ZIRAAT BANKASI A.S. – Dega në Kosovë

Shënime të pasqyrave financiare

Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë në Euro ("EUR"), përveq nëse ceket ndryshe)

15. Të hyrat nga tarifat dhe komisionet

	Periudha që përfundoi më 31 Dhjetor 2016	Periudha prej 30 Qershor 2015 deri 31 Dhjetor 2015
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet		
Tarifat nga shërbimi i llogarisë	1,516	162
Pagesat ndërkombëtare	11,386	1,978
Pagesat vendore	2,519	374
Garancionet dhe letër kreditë	1,703	12
Tjera	60	22
Gjithsej të hyrat nga tarifat dhe komisionet	17,184	2,548
Shpenzimet nga tarifat dhe komisionet		
Pagesat ndërkombëtare	(4,498)	(963)
Pagesat vendore	(3,176)	(2,907)
Tarifat për Bankën Qëndrore	(324)	(1,142)
Tarifat e tjera	(209)	(136)
Gjithsej shpenzimet nga tarifat dhe komisionet	(8,207)	(5,148)
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	8,977	(2,600)

16. Humbja/Fitimi nga këmbimi valutor

	Periudha që përfundoi më 31 Dhjetor 2016	Periudha që përfundoi më 31 Dhjetor 2015
Fitimi nga këmbimi valuator	2,525	178
Humbja nga këmbimi valuator	(805)	-
Humbja/fitimi i këmbimit valutor	1,720	178

17. Shpenzimet administrative

	Periudha që përfundoi më 31 Dhjetor 2016	Periudha prej 30 Qershor 2015 deri 31 Dhjetor 2015
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	306,506	157,043
Shpenzimet e personelit (shiko më poshtë)	226,051	201,283
Mirembajtja e programeve softverik	144,758	75,961
Shpenzimet e taksave dhe komisionet	103,000	67,483
Shpenzimet e qirasë	64,954	54,175
Shpenzimet e mirëmbajtjes së kompjuterëve	47,153	23,630
Shpenzime ligjore dhe të auditimit	25,136	15,053
Telekomunikimet	20,448	13,012
Shpenzime të tjera	18,241	48,789
Shërimet publike	11,044	5,773
Kostot e sigurisë dhe të sigurimit	8,777	5,126
Paisjet e zyrës	5,976	8,250
Shpenzimet e pastrimit	5,207	3,094
Shpenzimet e reprezentacionit	3,846	2,543
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit	1,724	1,210
Shpenzimet e donacionit	1,500	-
Shpenzimet e marketingut dhe sponsorizimit	1,363	6,456
Shpenzimet e udhëtimit	516	1,748
Gjithsej	996,200	690,628

TURKIYE CUMHURİYETİ ZIRAAT BANKASI A.S. – Dega në Kosovë
Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016
(Të gjitha shumat janë në Euro (“EUR”), përveq nëse ceket ndryshe)

17. Shpenzimet administrative (vazhdim)

Shpenzimet e personelit

	Periudha që përfundoi më 31 Dhjetor 2016	Periudha prej 30 Qershor 2015 deri 31 Dhjetor 2015
Shpenzimet e pagave	180,818	163,051
Kontributet e obligueshme pensionale të stafit	20,283	17,821
Sigurimi shëndetësor	4,645	2,128
Shpenzime të tjera	20,305	18,283
Gjithsej shpenzimet e personelit	226,051	201,283

18. Shpenzimet e tatimit në fitim

	Periudha që përfundoi më 31 Dhjetor 2016	Periudha prej 30 Qershor 2015 deri 31 Dhjetor 2015
Shpenzimi i tatimit aktual në fitim	-	-
Tatimi i shtyre kreditor në të ardhura	78,966	-
Shpenzimet tatimore	78,966	-

Të detajuara në vijim janë të llogaritura shpenzimet aktuale të tatimit mbi të ardhurat dhe tatimi i shtyrë i asestit.

	Periudha që përfundoi më 31 Dhjetor 2016	Periudha prej 30 Qershor 2015 deri 31 Dhjetor 2015
Humbja para tatimit	(719,017)	(677,474)
Tatimi teorik mbi të ardhurat	(71,902)	-
Diferencat permanente	(7,064)	-
Tatimi i shtyrë kreditor	(78,966)	-

Banka ka njohur të ardhura nga tatimi i shtyrë për humbjet tatimore të pashfrytëzuara të bartura në vlerë 78,966 Euro, të cilat mbarojnë si në vijim:

	Periudha që përfundoi më 31 Dhjetor 2016	Periudha prej 30 Qershor 2015 deri 31 Dhjetor 2015
<i>Humbjet tatimore të pashfrytëzuara të bartura që mbarojnë më:</i>		
- 31 December 2022	(719,017)	-
Gjithsej humbje tatimore të pashfrytëzuara të bartura	(719,017)	-

Në fuqi nga Shtatori 2015, Norma e tatimit mbi të ardhurat e korporatave është vendosur në 10% në përputhje me rregulloret tatimore të Kosovës aktualisht në fuqi, Ligji nr. 05/L-029 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.

19. Shpalosje për palët e ndërlidhura

Palët konsiderohen në përgjithësi të jenë të lidhura në qoftë se palët janë nën kontrollin e përbashkët, ose njëra palë ka aftësi për të kontrolluar palën tjetër ose ka aftësi të ushtrorë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale. Duke e konsideruar cdo marrëdhënie ndërmjet palëve, vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies, dhe jo vetëm formës ligjore. Banka është e kontrolluar nga TURKIYE CUMHURİYETİ ZIRAAT BANKASI A.Ş. e inkuorporuar në Turqi (“Prindi”), e cila zotëron 100% të aksioneve të zakonshme më 31 Dhjetor 2016. Banka kryen një numër të transaksioneve të palëve të ndërlidhura në rrjedhën e operacioneve të saj të rregullta. Transaksionet përfshijnë depozitat dhe shpenzimet. Këto transaksione janë kryer në kushte normale komerciale dhe çmimet e tregut. Tabela në vijim përmbledh transaksionet e palëve të ndërlidhura, bilancet e pasurive dhe shpenzimeve të cilat kanë ndodhur gjatë periudhës që përfundoi 31 Dhjetor 2016.

TURKIYE CUMHURIYETI ZIRAAT BANKASI A.S. – Dega në Kosovë

Shënime të pasqyrave financiare

Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë në Euro ("EUR"), përveq nëse ceket ndryshe)

19. Shpalosje për palët e ndërlidhura (vazhdim)

31 Dhjetor 2016	Marrëdhënia	Gjithsej
Llogaria aktuale në Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S	Kompania mëmë	35,393
Detyrimet tek Ziraat Bank – Dega në Bulgari	Entitetet nën kontroll të përbashkët	5,702,475
Gjithsej		5,737,868
Shpenzimet		
Shpenzimet e zyrës qendrore	Kompania mëmë	17,126
Gjithsej		17,126
Të ardhurat		
Të ardhurat e zyrës qendrore	Kompania mëmë	17,126
Gjithsej		17,126

Kompenzimi i menaxhmentit kryesor

	Periudha që përfundoi më 31 Dhjetor 2016	Periudha prej 30 Qershor 2015 deri 31 Dhjetor 2015
Pagat	95,055	43,740
Gjithsej	95,055	43,740

20. Artikujt jashtë-bilancor, detyrimet financiare dhe ngjarjet e paparashikuara

a) Garancionet dhe letër kreditë

Zotimet kreditore përfshijnë zotimet për të dhënë kredi, letër kreditë dhe garancioni, të dezajnuar për të përmbushur nevojat e konsumatorëve të bankës. Letër kreditë dhe garancionet e dhënë konsumatorëve, e obligojnë bankën të bëjë pagesa në emër të konsumatorëve nëse konsumatorët dështojnë të performojnë sipas kushteve të kontratës. Zotimet për të dhënë kreditë paraqesin zotimet kontraktuale për të dhënë hua dhe kredi qarkulluese. Zotimet përgjithësisht kanë data fikse të skadimit, apo klauzola tjera për shkëputje. Pasiqë zotimet mund të skadojnë pa u tërhequr, shumat totale jo domosdoshmërisht paraqesin nevojën për para të gatshme.

Shuma agregate e zotimeve të garancioneve dhe letrave të kredisë të lëshuara nga bankat janë:

